



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

## THIRRJE PËR APLIKIME PROJEKTESH (2)

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në përmbushje të objektivave, funksioneve dhe kompetencave sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për periudhën 2017- 2019, shpall këtë Thirrje për Aplikime Projektesh (2) për institucione që lidhen me mediat dhe organizata të shoqërisë civile.

Ato subjekte që janë të interesuara në komponentët dhe aspektet e mëposhtme, ftohen që, brenda datës **03.06.2019, ora 11.00**, të paraqesin në zyrën e protokollit të AMA-s propozimin për projekt e fokusuar në:

Komponenti i parë: Edukimi për median - Nevoja e zhvillimit të këtij edukimi, identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjedhje përmes ekspertizave, veçanërisht edukimi për median tek fëmijët dhe adoleshentët, nisur edhe nga nevojat e ndryshimeve të Direktivës së BE-së.

Komponenti i dytë: Gjuha e urrejtjes - Çështje programore që lidhen me radiot e komunitetit, e sidomos radiot fetare, një çështje e diskutuar dhe trajtuar nga vetë Bordi i AMA-s, për shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe forcimin e harmonisë fetare përmes transmetimeve audio.

Komponenti i tretë: Barazia gjinore - Promovimi i *gender equality* tek mediat audiovizive, qoftë në përmbajtje të programeve, qoftë në strukturat e mediave audiovizive, si dhe shmangia e diskriminimit gjinor dhe klisheve gjinore në mediat audiovizive.

Komponenti i katërt: Kujtesa dhe interpretimi i krimeve të periudhës komuniste në programet audiovizive.

1. Për komponentin e parë, *edukimi për median - Nevoja e zhvillimit të këtij edukimi, identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjedhje përmes ekspertizave*, qëllimi dhe synimi është për të ftuar në aplikim subjekte të interesuara për:

- Realizimin e një studimi dhe analize mbi edukimin mediatik, në raport edhe me ndryshimet e Direktivës së re të BE-së për shërbimet audiovizive;
- Identifikimin e problemeve dhe ofrimi i një ose disa zgjidhje përmes ekspertizave.

2. Për komponentin e dytë, *gjuha e urrejtjes - Çështje programore që lidhen me radiot e komunitetit, e sidomos radiot fetare, një çështje e diskutuar dhe trajtuar nga vetë Bordi i AMA-s, për shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe forcimin e harmonisë fetare përmes transmetimeve audio*, qëllimi dhe synimi është për të ftuar për aplikim subjekte të interesuara për:

- Realizimin e një studimi dhe analize të transmetimeve audio, mbështetur mbi çështje programore që lidhen me radiot e komunitetit, e sidomos radiot fetare, për shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe forcimin e harmonisë fetare.

3. Për komponentin e tretë, *barazia gjinore - promovimi i gender equality tek mediat audiovizive, qoftë në përmbajtje të programeve, qoftë në strukturat e mediave audiovizive, si dhe shmangia e diskriminimit gjinor dhe klisheve gjinore në mediat audiovizive.*

*mes transmetimeve audio, qëllimi është:*

-Realizimin e një studimi dhe analize të performancës në tregun audioviziv shqiptar, të përmbajtjeve të transmetuara, fokusuar tek shmangia e diskriminimit me bazë gjinore, dhe jo vetëm në përmbajtje të programeve.

4. Për komponentin e katërt, *kujtesa dhe interpretimi i krimeve të periudhës komuniste në programet audiovizive, qëllimi dhe synimi është për të ftuar në aplikim subjekte të interesuara për:*

-Realizimin e një studimi dhe analize, përfshirë edhe publikimin, mbi kujtesën dhe interpretimin e krimeve të periudhës së diktaturës komuniste në programet audiovizive.

Për të gjithë të interesuarit aplikimi, detyrimisht, përshtatet në përmbajtje sipas modelit të formularit që gjendet në faqen online të AMA-s, [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al) (Formular për Aplikim Projekti), duke plotësuar çdo kërkesë të tij.

Aplikanti duhet të shprehet që në fillim për aspektin për të cilin ka interes, duke e cituar të plotë njërin prej aspekteve të shpjeguar më sipër. Më shumë informacion për procesin e aplikimit gjeni në udhëzimin përkatës (Udhëzim për Aplikim), i cili po ashtu gjendet në faqen online të institucionit.

Në planin buxhetor të projektit të propozuar, vetë aplikuesi, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetëfinansues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit. Fondi për të cilin një subjekt mund të aplikojë për t'u financuar nga AMA nuk duhet të kalojë vlerën 1,300.000 (një milion e treqind mijë) lekë.

Subjekteve të interesuar, që nuk respektojnë afatin kohor të dorëzimit të aplikimit, në protokollin e AMA-s, nuk u merret në dorëzim dokumentacioni.

Subjektet e interesuara, që nuk kanë plotësuar të gjitha kërkesat e formularit, apo janë jashtë fokusit të komponentëve dhe aspekteve të shpeguara më sipër, do të konsiderohen të skualifikuar.

**Projektet duhet të hartohen dhe planifikohen nga aplikuesit në mënyrë që finalizimi i tyre me produkte, evente, si dhe dorëzimi i të gjithë dosjes së dokumentacionit të bëhet brenda datës 09.12.2019.**

AMA do të vijojë komunikimin dhe procedimin e mëtejshëm vetëm me ata aplikues, të cilëve u vlerësohet projekti në përputhje me kërkesat e kësaj Thirrjeje për Aplikim.

**Autoriteti i Mediave Audiovizive**